

Kjo analizë e politikave publike, në pjesën e parë, shtjellon mundësitë që ofron një platformë që bazohet në teknologji informative të sofistikuar si ndreqe.com në ofrimin e shërbimeve publike në nivel komunal, në veçanti për menaxhimin e mbeturinave, dhe jep një pasqyrë të raportimeve qytetare të deponive ilegale të mbeturinave si dhe ndërhyrjet e komunave për të adresuar ato raportime bazuar në të dhëna një vjeçare.

Ndërsa në pjesën e dytë, kjo analizë sugjeron si të përmirësohet organizimi i administratës për të intervenuar më shpejt pas raportimeve të qytetarëve si dhe si të përpilohen kontrata më adekuate për pastrimin e deponive ilegale për mbeturina.

Përmirësimet në këto dy aspekte të menaxhimit të mbeturinave, apo çfarëdo ofrimi të shërbimeve tjera, e ngrit efikasitetin e ofrimit të shërbimeve dhe e ngrit komunikimin e institucioneve komunale me banorë të komunës të cilët e ka për qëllim t'iu shërbej.